

VENDIM
Nr. 447, datë 22.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 410, DATË 8.6.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË GODINËS SË ISH-NDËRMARRJES
SË PRODHIMIT ARTIZANAL (NPA), SHKOZET, DURRËS, FAMILJEVE TË
SHPRONËSUARA NË ZONËN E PORTO-ROMANOS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe të neneve 3, pika 2, e 7 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi 1, bashkëlidhur vendimit nr. 410, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Familjes së z. Isuf Tufa,	me sipërfaqe ndërtimi 55.00 m ²
Familjes së z. Fisnik Kika,	me sipërfaqe ndërtimi 107.68 m ²
Familjes së z. Rustem Dalipi,	me sipërfaqe ndërtimi 109.94 m ²
Familjes së z. Xhevahir Smeli,	me sipërfaqe ndërtimi 70.54 m ²
Familjes së z. Hajredin Jana,	me sipërfaqe ndërtimi 71.65 m ²